



Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

**RELACION**  
**PËR VENDIMIN**  
**PËR**  
**MIRATIMIN E SASISË SË FLETËVE TË VOTIMIT QË DO TË PRODHOHEN PËR**  
**CDO QENDËR VOTIMI PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË**  
**BASHKISË HIMARË, QARKU VLORË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 244, datë 05.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, caktoi datën 4 Gusht 2024, si ditën e zgjedhjeve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë.

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Në mbështetje të nenit 97, pika 4, të Kodit Zgjedhor, përcaktohet që sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 përqind.

Në referim të nenit 10, të udhëzimit nr. 1, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, përcaktohet afati dhe mënyra e dërgimit të të dhënave për numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve për çdo QV.

Nga përpunimi i të dhënave të listës përfundimtare të zgjedhësve marrë nga DPGJC në zgjedhjet e datës 04.08.2024, rezulton se në Bashkinë Himarë numri i zgjedhësve është **23.074** zgjedhës, ndërsa numri i qendrave të votimit është **36 QV**.

Referuar pikës 4, të nenit 97, të Kodit Zgjedhor, sasia e fletëve të votimit që duhet të prodhohet për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, duke shtuar 2% (përqind) mbi numrin e zgjedhësve, është **23.535** (njëzet e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë) fletë votimi.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”.

**Daniela ALIMEMETI** - Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit  
**Madalena KOJA** - Drejtorja e Ligjshmërisë  
**Majlinda ÇELMETA** - Sekretari i Përgjithshëm (në mungesë dhe me autorizim)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E SASISË SË FLETËVE TË VOTIMIT QË DO TË PRODHOHEN PËR  
CDO QENDËR VOTIMI, PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË  
HIMARË, QARKU VLORË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 97, pika 4, dhe nenit 99, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

- Miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohet për çdo qendër votimi, për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Illirjan CELIBASHI**

Kopje: 3

Afati i ruajtjes: 3 vjet

D.Alimemeti \_\_\_\_\_

M.Çelmeta \_\_\_\_\_

Data: dd mm vvvv Nr: .....

Ora: hh:mm



“Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo Qendër Votimi për zgjedhjet e për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”.

**Sasia e fletëve të votimit për bashkinë Himarë**

Nr	QV	Zgjedhes	2%	Sasia e fletëve të votimit
1	4560/00	784	15,68	800
2	4561/00	417	8,34	425
3	4562/00	592	11,84	604
4	4562/01	567	11,34	578
5	4563/00	689	13,78	703
6	4563/01	687	13,74	701
7	4563/02	681	13,62	695
8	4565/00	698	13,96	712
9	4565/01	672	13,44	685
10	4566/00	623	12,46	635
11	4566/01	645	12,9	658
12	4569/00	907	18,14	925
13	4579/00	446	8,92	455
14	4580/00	557	11,14	568
15	4581/00	637	12,74	650
16	4581/01	627	12,54	640
17	4582/00	370	7,4	377
18	4583/00	804	16,08	820
19	4584/00	596	11,92	608
20	4584/01	580	11,6	592
21	4585/00	554	11,08	565
22	4585/01	538	10,76	549
23	4587/00	732	14,64	747
24	4588/00	956	19,12	975
25	4588/01	938	18,76	957
26	4589/00	691	13,82	705
27	4590/00	794	15,88	810
28	4590/01	764	15,28	779
29	4591/00	892	17,84	910
30	4591/01	881	17,62	899
31	4592/00	616	12,32	628
32	4593/00	448	8,96	457
33	4595/00	434	8,68	443
34	4598/00	616	12,32	628
35	4599/00	318	6,36	324
36	4600/00	323	6,46	329
<b>Total</b>		<b>23074</b>	<b>461,48</b>	<b>23535</b>